



XOPC
ОПЦИИ ЗА ЗДРАВ ЖИВОТ СКОПЈЕ



Проект финансиран од ЕУ - проектот ARYSE (Социјално зајакнување на младите во ризик) е финансиран од Европската Унија, претставувана од Европската комисија



UDHËZUES

për ballafaqim me rreziqet nga delikuenca te nxënësit



Shkup, 2019



XOPC
ОПЦИИ ЗА ЗДРАВ ЖИВОТ СКОПЈЕ



Проект финансиран од ЕУ - проектот ARYSE (Социјално
зајакнување на младите во ризик) е финансиран од
Европската Унија, претставувана од Европската комисија



UDHËZUES

për ballafaqim me rreziqet nga delikuenca te nxënësit

Botues:

Instituti për hulumtime strategjike dhe edukim - IHSE
Asociacioni për iniciativa zhvillimore – Zenit Shkup

Bordi redaktues

Aleksandar Nikolov
Miso Dokmanovic

Autorët

Daniel Pavlovski
Aleksandar Petkovski

Botimi mund të shkarkohet falas në:
www.isie.org.mk
www.zenith.org.mk

Ky botim është përpunuar në kuadër të projektit “Ballafaqimi me delikuencën e të miturve: novacione në parandalimin dhe përfshirjen sociale”, i mbështetur nga Bashkimi Evropian përmes projektit ARYSE (përforcimi social i të rinjve në rrezik). Përmbajtja e botimit është përgjegjësi e vetme e autorit, dhe nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

Rezyme	5
Hyrje	7
Metodologjia	8
Përshkrimi i problemit.....	9
Faktori i rrezikut dhe faktorët e mbrojtjes	9
Adoleshenca	10
Identiteti.....	11
Rezultatet nga hulumtimi	12
Analiza e të dhënave nga anketa e bërë përmes internetit	12
Anketa me personat e rinj	12
Anketa përmes internetit me personat e rritur.....	14
Korniza ligjore	17
Analiza e të dhënave nga vizita në burgun për të miturit në Ohër	18
Të miturit që vuajnë dënim me burg	18
Të miturit të cilëve u është shqiptuar masë edukuese dërgim në shtëpinë edukuese përmirësuese.....	21
Rekomandimet për parandalim më efektiv të delikuencës së të miturit dhe mbështetje të të rinjve në rrezik.....	23
Niveli familjar	23
Niveli arsimor	26
Niveli shoqëror	28
Bibliografia.....	31

REZYME

Delikuenca e të miturve e imponon nevojën për qasje multidisiplinore adekuate në më shumë nivele me qëllim parandalimin dhe pengimin e suksesshëm të tij. Delikuenca e të miturve do të thotë që i mituri është në konflikt me normat morale dhe juridike në shoqërinë dhe kërkon reagim adekuat në drejtim të ballafaqimit të suksesshëm me pasojat negative që i shkakton.

Ky dokument ka për qëllim të japë rekomandime për parandalim më efikas të delikuencës së të miturve dhe mbështetje të të rinjve në rrezik në bazë të analizës së literaturës adekuate dhe akteve normative, të dhënave të fituara nga anketa e realizuar përmes internetit me të miturit dhe të rriturit, si dhe nga hulumtimi i realizuar në institucionin ndëshkimor-përmirësues Burgu në Ohër.

Analiza tregon se familja paraqet faktor i cili ka rëndësi të jashtëzakonshme në dukurinë e delikuencës së të miturve. Përqindje e lartë e të miturve të cilëve u është shqiptuar masë edukuese dërgim në shtëpinë edukuese përmirësuese dhe e të miturve që vuajnë dënim me burg vijnë nga familje me marrëdhënie të prishura të anëtarëve, familje me status të ulët sociokulturor, me kushte të këqija materiale dhe banimi. Një ndër arsyet e paraqitjes së sjelljes delikuede te të miturit është edhe papjekuria e tyre emocionale, sistemi joadekuat për vetëkontroll, ballafaqim me stresin dhe sfidat.

Një e dhënë veçanërisht shqetësuese është fakti se një pjesë e të miturve e kanë lëshuar procesin arsimor para kohe dhe e kanë ndërprerë shkollimin e tyre, por gjithashtu është alarmante gjendja edhe te të miturit të cilët ende shkollohen, sepse shkolla nuk ka arritur që ta detektojë në kohë sjelljen e të miturve dhe në bashkëpunim me subjektet tjera relevante ta korrigjojë atë.

Është i domosdoshëm përforcimi i rolit të familjes me qëllim për të pasur mundësi të sigurojë kushte për rritje dhe zhvillim të drejtë të fëmijëve dhe me atë edhe parandalim të delikuencës së të miturve. Familja, bashkë me subjektet tjera relevante, duhet t'u ndihmojë të rinjve që të ballafaqohen suksesshëm me sfidat në të gjitha fazat zhvillimore, njëkohësisht duke e nxitur pavarësinë e tyre, zhvillimin e sistemit adekuat të vlerave, shkathtësive për ballafaqim me sfidat dhe ndërtimin e mekanizmave për ballafaqim me stresin dhe zhvillimin e vetëkontrollit.

Në këtë detyrë të ndërlikuar përveç familjes është e domosdoshme të përfshihet edhe shkolla përmes përforcimit të funksionit edukativ, i cili, përveç karakterit arsimor, ka rëndësi të jashtëzakonshme në zhvillimin e të rinjve. Shkollat duhet të ndërmarrin përgjegjësi më të madhe në njohjen në kohë të simptomave të nxënësit të cilat

sinjalizojnë se të njëjtit ballafaqohen me rreziqe të caktuara të cilat mund të ndikojnë në paraqitjen e sjelljes delikuede dhe neutralizimin adekuat të tyre.

Shkolla në bashkëpunim me autoritetet, shoqërinë civile dhe komunitetin e biznesit, duhet të zhvillojë dhe implementojë programe edukative mësimore dhe jashtëmësimore përmes të cilave do t'u mundësojnë nxënësve ta kalojnë kohën e tyre të lirë në mënyrë pozitive dhe kreative në përputhje me nevojat, ankesat dhe potencialet e tyre. Mes tjerash, duhet t'u ofrojë nxënësve aktivitete në sferën e sportit, artit, shkencës, ndihmës së komuniteteve, punës praktike etj., ku ato do të mund t'i tregojnë por edhe t'i zhvillojnë potencialet e tyre, ndërsa njëkohësisht të ndërtojnë sistem adekuat të vlerave në të cilin do të dominojë sinqeriteti dhe humanizmi.

HYRJE

Delikuenca e të miturve shënon se i mituri vjen në konflikt me shoqërinë, përkatësisht normat, vlerat dhe ligjet e tij. Në kuptimin më të gjerë me delikuencë të të miturve nënkuptohet sjellje me të cilën shkelen normat juridike dhe morale në shoqërinë e caktuar dhe që shkakton reagim shoqëror i cili është i orientuar në mbrojtjen e të mirave dhe vlerave shoqërore, ndërsa në kuptimin më të ngushtë nënkupton shkelje vetëm të normave juridike.

Delikuenca e të miturve del nga rrethana të shumta sociale negative në të cilat fëmijët rriten dhe kërkon ndërhyrje të qartë dhe komplekse me qëllim sanimin e faktorëve që kanë kontribuar për sjelljen e tillë, si dhe korrigjimin e sjelljes së fëmijës. Delikuenca e fëmijës nga njëra anë karakterizohet me rritjen e vazhdueshme të numrit të veprave penale, dhe nga ana tjetër me zvogëlimin e kufirit të pleqërisë së kryerësve. Gjithashtu, rritet edhe serioziteti i veprave penale, përkatësisht gjithnjë më evidente janë rastet e veprave të rënda penale të cilat kryhen nga persona të mitur.¹ Karakteristikat e cekura të kriminalitetit miturak bashkëkohor sugjerojnë nevojën për qasje multidisiplinore sistematike në më shumë nivele me qëllim të ballafaqimit të suksesshëm dhe adekuat me këtë dukuri negative shoqërore.

Udhëzuesi ka për qëllim t'i identifikojë faktorët të cilët ndikojnë mbi dukurinë e delikuencës, përkatësisht t'i detektojë faktorët e rrezikut të cilët kontribuojnë që i mituri të vijë në konflikt me normat juridike dhe morale në mjedisin ku jetojmë. Gjithashtu, qëllimi është që të detektohen edhe faktorët e mbrojtjes të cilat janë të rëndësishme për rritje dhe zhvillim të drejtë të të rinjve dhe për parandalim të suksesshëm dhe ballafaqim me delikuencën e të miturve. Qëllimi themelor është adresimi i segmenteve kryesore të cilëve duhet t'u kushtohet vëmendje adekuate nga ana e të gjitha subjekteve relevante me qëllim përmirësimin e gjendjes në këtë sferë.

Ky dokument përbëhet nga disa pjesë. Në pjesën e parë është bërë përshkrim i problemit, në të cilin janë përshkruar faktorët e rrezikut dhe faktorët e mbrojtjes të cilët janë të rëndësishëm për dukurinë e delikuencës së të miturve, gjithashtu, në këtë pjesë është përshkruar periudha e adoleshencës dhe faktorët e rëndësishëm në formimin e identitetit të të miturit.

Në pjesën e dytë është përshkruar metodologjia e cila është përdorur për mbledhje, paraqitje dhe analizë të të dhënave. Në pjesën e tretë janë paraqitur të dhënat e mbledhura nga literatura e konsultuar, korniza ligjore, si dhe të dhënat nga anketa e realizuar përmes internetit me personat e mitur dhe të rritur, por edhe të dhënat e fituara nga vizita në burgun e të miturve në Ohër.

¹ Dimitrijoska, S. 2012. Punë sociale me të mitur kryerës të veprave penale. Fakulteti filozofik, Shkup

Në pjesën e katërtë janë rekomandimet për parandalim më efektiv të delikuencës së të miturve dhe mbështetje të të rinjve në rrezik.

METODOLOGJIA

Gjatë përpunimit të udhëzuesit është shfrytëzuar literaturë adekuate nga sfera e delikuencës së të miturve me qëllim definimin adekuat të elementeve kryesore të kësaj dukurie. Është bërë edhe analizë e rregullativës vendore dhe ndërkombëtare me qëllim përcaktimin e kornizës normative dhe institucionale e cila ka të bëjë me delikuencën e të miturve.

Për përcaktimin adekuat të shkaqeve për dukurinë e delikuencës së të miturve në Republikën e Maqedonisë së Veriut më 03.06.2019 është realizuar vizitë në institucionin ndëshkimor-përmirësues Burgu në Ohër. Gjatë vizitës u shqyrtuan kushtet hapësinore në të cilat funksionon institucioni, është bërë intervistë me psikologun nga njësia për risocializim dhe është bërë analizë e detajuar e të dhënave të përfshirë në dosjet individuale të të miturve të cilat momentalisht qëndrojnë në burgun për të miturit në Ohër.

Përveç kësaj, në periudhën nga muaji maj deri në muajin qershor 2019 është bërë anketë përmes internetit me të miturit dhe me të rriturit, me qëllim për të marrë informata të cilat do të ndihmojnë në sqarimin e shkaqeve për dukurinë e sjelljes delikuede te të miturit, si dhe për mënyrat për parandalim të suksesshëm dhe ballafaqim me delikuencën e të miturve.

Me qëllim marrjen e informatave nga subjekte relevante të cilat punojnë në sferën e delikuencës së të miturve më 27.06.2019 është realizuar takim pune me përfaqësuesit e Këshillit Shtetëror për Parandalim të Delikuencës së Fëmijëve, IP Enti për veprimtari sociale – Shkup, Qendrat për punë sociale të Qytetit të Shkupit, Kumanovës, Prilepit dhe Resnjës, si dhe përfaqësuesit e sektorit joqeveritar dhe profesorët universitarë.

Nga aktivitetet e realizuar për mbledhje të të dhënave janë marrë informata të rëndësishme të cilat do të kontribuojnë në identifikimin e shkaqeve të mundshme për dukurinë e sjelljes delikuede te të miturit.

Analiza ka edhe kufizime të caktuara të cilat duhet të merren parasysh gjatë formulimit të konkluzioneve dhe dhënies së rekomandimeve përkatëse. Një prej elementeve kufizuese është madhësia e ekzemplarit, duke pasur parasysh se në institucionin ndëshkimor-përmirësues Burgu – Ohër, në momentin e realizimit të vizitës kanë qëndruar gjithsej 22 persona të mitur, nga të cilët 10 vuajnë dënimin me burg dhe 12 masë edukuese dërgim në shtëpinë edukative-përmirësuese. Gjithashtu, element kufizues është vëllimi i informatave të përfshirë në dosjen individuale të të miturve, megjithëse në to ka të dhëna të cilat do të ndihmojnë në kuptimin e shkaqeve për

dokurinë e sjelljes delikuate, megjithatë duhet të jemi të kujdesshëm në miratimin e konkluzioneve.

Njëkohësisht, duhet të jemi të kujdesshëm edhe në lidhje me të dhënat e fituara nga anketat e realizuara përmes internetit, si në lidhje me madhësinë dhe reprezentativitetin e ekzemplarit, ashtu edhe në lidhje me sinqeritetin e përgjigjeve të personave të anketuar.

PËRSHKRIMI I PROBLEMIT

Faktori i rrezikut dhe faktorët e mbrojtjes

Në faktorët e rrezikut bëjnë pjesë kushtet që e rrisin mundësinë e paraqitjes së sjelljes delikuate, ndërsa faktorët e mbrojtjes janë ato kushte dhe ndikime të cilat e zvogëlojnë këtë mundësi, përkatësisht e zvogëlojnë efektin e dëmshëm potencial të faktorëve të rrezikut.

Janë identifikuar katër sfera të faktorëve të rrezikut:

1. Faktorë individualë
2. Faktorë familjarë
3. Grupi i moshatarëve
4. Faktorët mesatarë

Asnjë faktor rreziku i izoluar nuk mund të shpie në paraqitjen e delikuencës së të miturve. Faktorët e rrezikut nuk funksionojnë në mënyrë të izoluar dhe zakonisht janë kumulativë, sa më shumë faktorë rreziku janë të pranishëm te të rinjtë, aq është më e madhe mundësia e manifestimit të sjelljes delikuate.

Në situata të caktuara, ekzistimi i një faktori të rrezikut ndikon në drejtim të zhvillimit dhe paraqitjes së faktorëve tjerë të rrezikut, me ç'rast rritet edhe mundësia e paraqitjes së më shumë rreziqeve sociale te të rinjtë.

Në bazë të njohurive shkencore dhe praktike vendore dhe ndërkombëtare, imponohet nevoja që periudhës së adoleshencës t'i kushtohet vëmendje adekuate në drejtim të parandalimit të delikuencës së të miturve. Gjegjësisht, kjo periudhë është veçanërisht e rëndësishme, për faktin që në të ndodhin numër i madh i ndryshimeve te i mituri të cilët prej tij kërkojnë shumë energji për përshtatje dhe ballafaqim të suksesshëm me to.

Adoleshenca

Në periudhën e adoleshencës ndodhin numër i madh i ndryshimeve të rëndësishme në funksionet anatomike, emocionale, intelektuale dhe sociale. Kjo periudhë karakterizohet me rritje dhe zhvillim intensiv, por edhe me konflikte dhe trazira. I mituri ballafaqohet me pamjen e tij trupore, nevojat e tij të fuqishme seksuale, qëndrimin e tij të ndryshuar ndaj rrethinës, por edhe qëndrimin e ndryshuar të rrethinës ndaj të miturit. I mituri pret prej vetes shumë, por edhe rrethina prej adoleshentit pret shumë.

Gjatë adoleshencës ndodhin ndryshime të dukshme në raportet sociale me:

- Prindërit
- Moshatarët
- Mjedisin shoqëror

Ndryshohet cilësia e raportit me prindërit – në fëmijëri prindi ofron kujdes, mbrojtje, ndihmë, ndërsa fëmija ia kthen duke e dëgjuar. Në adoleshencën bëhet fjalë për raport ndërmjet të dyve barazisht. Komunikimi me prindërit bëhet selektiv: adoleshenti vendos që për disa punë të bisedojë me njërin prind, për disa punë tjera me prindin tjetër, për punë të treta me të dy prindërit, por ka tema për të cilat nuk bisedon me asnjërin prind. Në adoleshencën priset miti se prindi është figurë e jashtëzakonshme që di dhe mund të bëjë gjithçka, vetëdijesohet se prindi ka karakteristika, virtyte, aftësi pozitive, por njëkohësisht ka edhe mangësitë e veta, nuk është i gjithëfuqishëm, nuk di gjithçka, nuk mund të bëjë gjithçka.

Në adoleshencën zhvillohet procesi i individualizmit, me ç'rast i mituri lirohet nga gjendja që të varet nga prindërit, por njëkohësisht insiston të mbetet në lidhje me to. Njëkohësisht zvogëlohen kontaktet me prindërit, ndërsa rritet gjatësia e kohës së kaluar i veçuar nga prindërit. Adoleshenti ka jetën e vet private, por megjithëse insiston të sigurojë mëvetësi dhe distancë nga prindërit e vet, ai synon t'i mbajë kontaktet me to. I respekton, dëshiron të përmbushë disa kërkesa të tyre, i njofton për një pjesë të punëve që i ndodhin jashtë shtëpisë.

Sipas një numri të madh kryerësish ndryshimet në adoleshencën i përshkruajnë përmes tre fazave.

Faza e parë është diferencimi, kur adoleshenti merr qëndrim kritik ndaj prindërve dhe qëndrimeve të tyre, refuzon një numër të madh të këshillave dhe propozimeve të tyre.

Gjatë fazës së dytë adoleshenti e praktikon pavarësinë nga prindërit. Ndjehet i pagabueshëm në vendimet dhe veprimet, nuk i përfshin këshillat të cilat ia japin prindërit të jetë i kujdesshëm dhe i matur në veprimet e tyre.

Faza e tretë e konsolidimit - është ndjenjë e ndërtuar për pavarësinë dhe individualitetin, por edhe në një shkallë të caktuar pranim i mbështetjes së prindërve.

Marrëdhëniet me moshatarët, gjithashtu përjetojnë transformim të dukshëm. Gjatë kësaj periudhe ndodhin ndryshime në natyrën dhe rëndësinë e miqësisë. Miku përjetohet si person të cilit adoleshenti mund t'i besojë për disa punë, ndërsa raportet bazohen në respektimin dhe besimin e ndërsjellë. Miqtë i zgjedhin vetë, në krahasim me periudhat zhvillimore paraprake, kur shpesh janë shoqëruar me persona të zgjedhur nga ana e prindërve të tyre. Me atë zgjidhen miqtë me interesa të ngjashme me të cilat ndajnë kohë, emocione, përvoja, këshilla etj. Në këtë periudhë grupi i moshatarëve ka ndikim jashtëzakonisht të madh në jetën e të miturit, në momente dhe situata të caktuara bile edhe më të madh sesa familja.

Gjithashtu, në këtë periudhë ndryshohet edhe raporti i të miturit ndaj mjedisit shoqëror por edhe raporti i mjedisit shoqëror ndaj të miturit. Gjatë adoleshencës të miturit kanë përgjegjësi penale, ndërsa më vonë (në adoleshencën e mëvonshme) dhe të moshës madhore, kanë përgjegjësi para ligjit.

Gjatë periudhës së adoleshencës njëra prej detyrave kryesore është formimi i identitetit të fortë të mituri.

Identiteti

Identiteti nënkupton organizimin e brendshëm të nevojave, impulseve (instikteve) aftësive personale, bindjeve shoqërore-politike, të kuptuarin e vetvetes dhe të historisë personale. Sa më mirë që janë të zhvilluara dhe organizuara këto elemente, personi është më i vetëdijshëm për karakteristikat individuale personale, por edhe për ngjashmëritë me njerëzit tjerë, si dhe për anët e veta të forta dhe të dobëta. Sa më pak i zhvilluar identiteti personal, personi është më pak i vetëdijshëm për atë se çka e bën atë të dallohet prej të tjerëve dhe andaj për ta çmuar vlerën e vet më shumë mbështetet në burimet e jashtme (miq, kolegë, mësues, trajnues etj).

Sipas teorisë për zhvillim psikologjik të Erik Erikson, psikolog dhe psikoanalist, faza e formimit të identitetit ndodh gjatë adoleshencës. Përveç numrit të madh të ndryshimeve biologjike, ridefinimit të vetvetes në kuadër të familjes, zhvillimit të llojeve të reja të raporteve me moshatarët dhe përshtatjes së kërkesave gjithnjë më të mëdha nga ana e sistemit arsimor, adoleshentët në këtë fazë e testojnë vetveten dhe rrethinën e vet. Pyetjet më të shpeshta të cilat i parashtrojnë janë: Kush jamë unë? Çfarë dua të punoj? Kujt i besoj? Si përshtatem në mjedisin shoqëror? Në këtë mënyrë ato e ndërtojnë identitetin e tyre profesional, gjinor dhe ideologjik. Në rast të zgjidhjes së pasuksesshme të krizave të cilat janë karakteristike për këtë periudhë zhvillimore, vjen

deri te konfuzioni i identitetit, përkatësisht konfuzioni në rolet jetësore dhe shoqërore. Gjatë procesit të formimit të identitetit, adoleshentët eksperimentojnë me role të ndryshme të të rriturve me qëllim për ta gjetur veten në ato që u konvenojnë për shumë.

Gjatë adoleshencës ndodh edhe zhvillimi i dukshëm fizik dhe intelektual si dhe paraqitja e pritjeve të reja shoqërore nga adoleshenti, gjë që shpie në një kthesë pas së cilës adoleshenti lëviz në rrugën nga fëmijë në njeri të rritur (të pjekur). Vendimet për çështjet siç janë – me kë të dalë, a ta ndërpresë lidhjen ose jo, të hyjë në marrëdhënie seksuale ose jo, a të përdorë drogë, a të regjistrohet në fakultet ose të punësohet, cilin fakultet ta zgjedhë, a të mësojë ose të argëtohet, a të jetë aktiv politikisht ose jo – kontribuojnë për formimin e identitetit. Ndonjëherë sjellja e vendimeve mund të anashkalohet. Personi mund të mbështetet në vlerat paraprakisht miratuara prindërore (vlerat e prindërve) dhe në bazë të tyre ta caktojë sjelljen e ardhshme të vet. Adoleshentët kanë nevojë për veçim të vlerave personale, qëndrimeve dhe standardeve të adoleshentit, nga ato të cilat ia kanë mësuar prindërit gjatë fëmijërisë. Aftësia për t'i dalluar interesat, qëndrimet dhe vlerësimet personale prej atyre të prindërve pse nga ato të marra nga persona tjerë të cilët në njëfarë mënyre janë involvuar në jetën e adoleshentit, paraqet fillim të formimit të identitetit.

Ndikimi shoqëror reflektohet në familjen, raportet me miqtë, shkollën, komunitetet fetare, qendrat sportive dhe lloj tjetër të qendrave të cilat vendosin pritje të ndryshme për adoleshentët, në krahasim me pritjet kur kanë qenë fëmijë. Këto pritje përfshijnë bashkëpunim, harmonizim të qëndrimeve dhe aktiviteteve me njerëzit tjerë.


Sa i përket ndikimit të familjes, është me rëndësi që fëmija ta ndjejë mbështetjen dhe lidhshmërinë me anëtarët e familjes, duke nxitur njëkohësisht pavarësi të adoleshentit. Mbështetja sociale ose aprovimi nga ana e moshatarëve paraqet indikator të fuqishëm i perceptimit të vetvetes si një person me vlerë. Cilësia dhe stabiliteti i miqve adoleshentë, gjithashtu janë të lidhur fuqishëm me vetëbesimin gjë e cila është bazë e identitetit.

REZULTATET NGA HULUMTIMI

Analiza e të dhënave nga anketa e bërë përmes internetit


Anketa me personat e rinj

Anketa përfshiu 2049 të anketuar, nga të cilat 3% janë nxënës në shkollën fillore, 47% në shkollën mesme, ndërsa 42% janë studentë (grafiku nr. 1). Megjithatë më shumë fokusi ishte te të miturit, anketa përfshiu edhe persona të rinj të moshës madhore, sepse ato ende kanë përvoja të freskëta nga fëmijëria që i bën relevante për këtë hulumtim.



Grafiku nr. 1

Në grafikun nr. 2 mund të shihet se 35% të të rinjve të anketuar janë përgjigjur se në vitin e fundit një ose më shumë prej shokëve të tyre më të afërt janë maltretuar online, 32% janë maltretuar nga moshatarë në shkollë, 39% janë rrahur me dikë dhe 17% kanë vjedhur diçka. Mund të vijmë në përfundim se të rinjtë ballafaqohen me mjedis relativisht konfliktuoz.



Grafiku nr. 2

112% e të rinjve asnjëherë nuk kanë biseduar me prindërit e tyre, ndërsa 23% me personelin në shkollën në të cilën mësojnë ose kanë mësuar, për tema lidhur me pirjen e duhanit, alkoolit, përdorimin e drogës ose dhunës.

39% e të anketuarve janë përgjigjur se në shkollë kanë biseduar për mënyrat për ballafaqim me mllef/vetëkontroll, ndërsa 64% për mënyrat e zgjidhjes së konflikteve. Kjo tregon se një pjesë e mirë e nxënësve nuk kanë pasur mundësi që përmes procesit arsimor të marrin informata për këto tema dhe të përvetësojnë të kuptuarit dhe shkathtësi adekuate.

Kur kanë pasur rezultate të mira në shkollë, 10% të të miturve nuk janë lavdëruar nga prindërit, ndërsa 18% nuk janë lavdëruar as nga mësuesit. Njëra prej funksioneve të edukimit është që ta nxisë sjelljen e dëshiruar shoqërore, dhe së këndejmi është e dëshirueshme që mjedisi t'i dallojë dhe shpërblejë nxënësit që kanë arritur rezultate të mira.


Një e katërta nuk kanë pasur shumë mundësi të përfshihen në shkollë në aktivitete jashtë orëve të rregullta (p.sh. aktivitete sportive, seksione dhe aktivitete tjera jashtë klasës), që na shpie në përfundimin se nuk ka ofertë adekuate të aktiviteteve jashtëmësimore. Bile 86% të të miturve të anketuar dëshirojnë të kenë më shumë mundësi për të shkuar në praktikë në ndonjë kompani, ndërsa 76% dëshirojnë të angazhohen në ndihmën e komunitetit. Por, vetëm 33% kanë ditur ku mund të gjejnë mundësi për praktikë, ndërsa vetëm 32% dinë ku mund të gjejnë mundësi për vullnetarizëm në komunitetin. Kjo është fushë ku me sa duket është e nevojshme që institucionet dhe shoqëria civile të gjejnë mënyrë për ta përmirësuar informimin e të rinjve dhe të sigurojnë mundësi për praktikë dhe shërbim të komunitetit.

Kur bëhet fjalë për ndjenjën e sigurisë, 21% të të miturve të anketuar nuk ndjehen të sigurt në fqinjësinë në të cilën jetojnë, ndërsa 20% në shkollën në të cilën mësojnë.

Anketa përmes internetit me personat e rritur

Anketa përmes internetit me personat e rritur është bërë me 746 persona, ku më shumë janë përfaqësuar femrat me 78%, ndërsa meshkujt (22%).

Në Grafikon nr. 3 mund të shihet se te 7% të fëmijëve të tyre të anketuar pothuajse asnjëherë nuk pranojnë se nuk mund të jetë gjithmonë sipas tyre, ndërsa te 11% fëmija pothuajse asnjëherë nuk pranon kritikë konstruktive pa u hidhëruar. Shqetësuese janë edhe të dhënat që tregojnë se 6% pothuajse asnjëherë nuk janë të vetëdijshëm për ndikimin e sjelljes së tyre mbi tjerët, 6% nuk i dëgjojnë pikëpamjet e tjerëve, 6% pothuajse asnjëherë nuk dëshirojnë t'u ndihmojnë të tjerëve, por gjithashtu 6% pothuajse asnjëherë nuk kontrollohen kur ka mospajtime me të tjerët.



Grafiku nr. 3


68% e të anketuarve kanë deklaruar se ndonjëherë, ndërsa 14% pothuajse gjithmonë gjatë komunikimit në familjen e tyre ndërpriten kur flasin ose kur diskutojnë. Kjo e dhënë tregon komunikim joadekuat në familjen gjë e cila reflektohet seriozisht në marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve dhe krijon atmosferë joadekuatë për rritje dhe zhvillim normal të fëmijëve.

Në pyetjen nëse mendoni se kur fëmija juaj do të bëjë diçka të gabuar, biseda me të do të ishte më efikas sesa rrahja, 12% janë përgjigjur se pjesërisht nuk pajtohen dhe gjithashtu 12% se nuk pajtohen fare. Me sa duket ende ka prindër që mendojnë se rrahja është masë edukative adekuate dhe e dobishme.

Të dhënat në grafikun nr. tregojnë se 18% e prindërve konsiderojnë se pothuajse asnjëherë nuk marrin informata nga mësuesit për atë se si është fëmija në shkollë, 6% pothuajse asnjëherë nuk shkojnë në mbledhje prindërore, 6% pothuajse asnjëherë nuk komunikojnë me fëmijën se si sillet në shkollë dhe 2% pothuajse asnjëherë nuk e pyesin fëmijën e tyre se çfarë i ka ndodhur në shkollë. Këto të dhëna tregojnë se, megjithëse përqindja e të anketuarve është e vogël, përsëri ekzistojnë prindër të cilët janë në rrjedhë me atë se çfarë i ndodh fëmijës së tyre në shkollë. Si rrjedhojë e kësaj, fëmijët nuk kanë ndihmë adekuate nga familja e tyre për t'u ballafaquar me sfidat me të cilat ballafaqohen në shkollë, gjë e cila mund të manifestohet negativisht mbi suksesin e tyre në shkollë dhe sjelljen e tyre.

Sa shpeshë:


0-Mësuesi ju jep informata për atë se si është fëmija në shkollë?

**Grafiku nr. 4**

Rezultate të ngjashme japin edhe përgjigjet e pyetjeve për atë se sa e kalojnë prindërit kohën e lirë me fëmijët e tyre. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve 12% kanë deklaruar se pothuajse asnjëherë nuk luajnë lojëra ose nuk merren me ndonjë sport me fëmijën e tyre, ndërsa 5% pothuajse gjithmonë janë tepër të zënë dhe nuk kanë mundësi të bëjnë diçka me fëmijën e tyre.

Bile 50% nga të anketuarit nuk kanë pasur mundësi për të biseduar me dikë në shkollën ku mëson fëmija për atë se si ta pengojnë fëmijën të mos pikë duhan, alkool, të mos përdorë drogë ose dhunë. Ky është indikator i fuqishëm se një pjesë e shkollave nuk realizojnë aktivitete për informim të prindërve për parandalim të dukurive të caktuara negative shoqërore.

83% e të anketuarve konsiderojnë se delikuenca e të miturve është dukuri e shpeshtë në shtetin tonë, ndërsa 79% kanë ndonjë të afërt të prekur me këtë problem. Një përqindje e ngjashme prej 78% mendojnë se personat e prekur me këtë problem nëse marrin ndihmë dhe mbështetje adekuate, mund më tutje të jetojnë jetë normale.

A konsideroni se fëmija juaj është i sigurt?**Grafiku nr. 5**

22% e të anketuarve konsiderojnë se fëmijët e tyre nuk janë të sigurt në shkollë, ndërsa 37% nuk dinë nëse fëmijët janë të sigurt në shkollë. Në lidhje me çështjen e sigurisë së fëmijëve në mjedisin e drejtpërdrejtë në të cilin jeton (fqinjësi), 20% konsiderojnë se nuk janë të sigurt, ndërsa 35% nuk kanë ditur (grafiku nr. 5).

Korniza ligjore

Ligji për drejtësinë e fëmijëve e rregullon veprimin me fëmijët në rrezik dhe fëmijët kryerës të veprimeve që janë paraparë si vepra penale dhe kundërvajtje, kushtet për aplikimin e masave për ndihmë, kujdes dhe mbrojtje, masave edukative dhe alternative dhe masave për ndëshkim të fëmijëve dhe personave më të rinj të moshës madhore.²

Masa dërgim në shtëpinë edukative-përmirësuese aplikohet në raste kur duhet të aplikohen masa më të qëndrueshme dhe më të përforcuara për edukim dhe riedukim të të miturit dhe ndarje të tij të plotë nga mjedisi i deriatëhershëm (neni 46, paragrafi 1).

Në shtëpinë edukuese përmirësuese i mituri qëndron së paku një vit, e më së shumti pesë vite, përkatësisht deri sa t'i mbushë 23 vjet. Gjatë shqiptimit të kësaj mase gjykata nuk e cakton zgjatjen e saj, por për këtë vendos në mënyrë plotësuese (neni 46, paragrafi 3).

Gjykata e shqyrton nevojën e qëndrimit në shtëpinë edukuese përmirësuese çdo vit, me detyrë zyrtare, me propozim të prokurorit publik ose me propozim të shtëpisë edukuese përmirësuese (neni 46 paragrafi 4).

Në lidhje me shqiptimin e dënimeve ndaj personave të mitur, në Ligjin për drejtësi për fëmijët është paraparë se mund të dënohet fëmija mbi moshën 16 vjet me përgjegjësi penale, vetëm nëse për shkak të pasojave të rënda nga vepra e kryer dhe shkalla e lartë e përgjegjësisë penale nuk do të ishte e arsyeshme të shqiptohet masë edukuese (neni 50, paragrafi 1).

Fëmijës mbi moshën 16 vjeçare mund t'i shqiptohen dënimet në vijim (neni 50, paragrafi 2):

- burg për fëmijë,
- dënim me para,
- ndalim i drejtimit të mjetit motorik i llojit ose kategorisë së caktuar dhe
- dëbimi i të huajit nga vendi.

Burgu për fëmijë mund t'i shqiptohet fëmijës me përgjegjësi penale mbi 16 vjet i cili ka kryer vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg prej pesë vitesh ose dënim më i rëndë, nëse vepra është kryer në rrethana vështirësuese dhe në shkallë të lartë të përgjegjësisë penale të kryerësit e me ç'rast nuk do të ishte e arsyeshme të shqiptohet masë edukuese (neni 51, paragrafi 2). Burgu për fëmijë nuk mund të jetë

² Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 148 nga 29.10.2013


më i shkurtër se një vit dhe as më i gjatë se dhjetë vite (neni 51, paragrafi 3).

Analiza e të dhënave nga vizita në burgun për të miturit në Ohër

Me analizën janë përfshirë persona të mitur të cilëve u është shqiptuar dënim me burg për fëmijë dhe të cilët momentalisht të njëjtin e vuajnë në Burgun në Ohër, si dhe të miturit të cilëve u është shqiptar masa edukuese dërgim në shtëpinë edukuese përmirësuese.


Të miturit që vuajnë dënim me burg

Në institucionin ndëshkimor përmirësues Burgu – Ohër vendosen vetëm të miturit nga gjinia mashkullore. Në momentin e realizimit të hulumtimit dënim me burg vuanin gjithsej dhjetë persona të mitur.




Grafiku nr. 6 Mosha e të miturve që vuajnë dënim me burg

Popullata e përgjithshme e burgut përbëhet nga pjesëtarë të pakicave, siç mund të shihet në grafikun nr. 7.



Grafiku nr. 7 Kombësia e të miturve



Grafiku nr. 8 Lloji i veprës penale për të cilën i mituri është në

Në lidhje me llojin e veprave penale, dominojnë veprat vrasje dhe grabitje. Të miturit tjerë kanë kryer vjedhje të rënda, kanë bërë kontrabandë me emigrantë ose kanë kryer aksidente të rënda me të cilat e kanë rrezikuar sigurinë e njerëzve dhe pronës.

Në lidhje me karakteristikat personale dhe familjare të të miturve që vuajnë dënim me burg, nga të dhënat e marra mund veçohen profilet vijuese të të miturve:

A) Vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pronës në komunikacion:

- Nxënësi
- I padënuar
- Nuk zbatohen procedura për vepra tjera penale
- Nuk janë shqiptuar masa edukuese
- Marrëdhënie familjare normale
- Nën ndikimin e alkoolit

B) Kontrabandë me emigrantë:

- Nxënësi
- I padënuar
- Nuk zbatohen procedura për vepra tjera penale
- Nuk janë shqiptuar masa edukuese
- Marrëdhënie familjare normale

C) Vrasje:

- Nxënësi
- I padënuar
- Nuk zbatohen procedura për vepra tjera penale
- Nuk janë shqiptuar masa edukuese
- Marrëdhënie familjare normale

Analiza e detajuar e të dhënave për të miturit që vuajnë dënim me burg për vepra penale kundër sigurisë së njerëzve dhe pronës në komunikacion, kontrabandë me emigrantë dhe vrasje (që paraqet 50% të numrit të përgjithshëm të të miturve që vuajnë dënim me burg) tregon se bëhet fjalë për të mitur jo mjaft të pjekur, që janë të papjekur emocionalisht, të paqëndrueshëm dhe pa sisteme të ndërtuara adekuate për vetëkontroll në situata të stresit.

Nga analiza janë përpunuar profilet e të miturve që kanë kryer grabitje ose vjedhje të rëndës në vijim:

Ç) Grabitje:

- Analfabet
- E ka braktisur procesin arsimor
- Zbatohen procedura për vepra tjera penale
- Masa të shqiptuara edukuese
- Masë e shqiptuar institucionale
- Marrëdhënie të prishura familjare

D) Vjedhje të rënda:

- Analfabet
- E ka braktisur procesin arsimor
- Zbatohen procedura për vepra tjera penale

- Masa të shqiptuara edukuese
- Masë e shqiptuar institucionale
- Marrëdhënie të prishura familjare


Njëri prej të miturve që kanë kryer vjedhje të rënda ka qëndruar më parë në Shtëpinë për fëmijë pa prindër dhe kujdes prindëror “11 Tetor” dhe Institucionin publik për përkujdesje të fëmijëve me probleme sociale edukuese - Shkup.

Analiza e detajuar tregon se 50% të numrit të përgjithshëm të të miturve (të dënuar për vjedhje të rënda dhe grabitje) e kanë braktisur procesin arsimor dhe janë analfabet. Këto të mitur kanë kryer më shumë vepra penale, dhe ndaj tyre zbatohen procedura për vepra të kryera penale. Gjithashtu, shqetësues është edhe e dhëna se ndaj këtyre të miturve më parë është janë shqiptuar masa të caktuara edukuese dhe institucionale, por të njëjtit nuk e kanë arritur efektin e nevojshëm korrigjues. Një e dhënë tjetër shqetësuese është informata se të gjithë ato vijnë nga familje disfunksionale.

Analiza e marrëdhënieve familjare tregon se bëhet fjalë për familje me status të ulët sociokulturor, familje në të cilat ka marrëdhënie të prishura ndërmjet anëtarëve dhe familjeve që kanë kushte të këqija materiale dhe kushte të këqija për banim.

Të miturit të cilëve u është shqiptuar masë edukuese dërgim në shtëpinë edukuese përmirësuese

Gjatë analizës³ këtë masë e vuanin gjithsej 12 të mitur të gjinisë mashkullore.




Grafiku nr. 9 Mosha e të miturve

³ Qershor 2019 r.

Numri më i madh i të miturve, përkatësisht 10 janë të përkatësisë etnike rome, ndërsa të përkatësisë etnike maqedonase dhe shqiptare ka vetëm nga një 1 të mitur.

Numri më i madh i të miturve (42%) kanë kryer vjedhje të rënda. Një e katërta kanë kryer grabitje dhe gjithashtu kanë kryer sulm gjinor ndaj fëmijës që nuk ka mbushur 14 vjet.



Grafiku nr. 10 Lloji i veprës penale për të cilën është shqiptuar masë edukuese

Analiza e dosjes së të miturve të cilëve u është shqiptuar kjo masë e jep profilin e të miturit në vijim:

- Analfabet
- E ka braktisur procesin arsimor
- Zbatohen procedura për vepra tjera penale
- Masa të shqiptuara edukuese
- Marrëdhënie të prishura familjare
- Kushte që këqija materiale dhe banesore

Analiza e të dhënave tregon se 2 të persona të mitur kanë të vendosur paraprakisht në Shtëpinë për fëmijë pa prindër dhe kujdes prindër “11 Tetor” dhe në Institucionin publik për përkujdesje të fëmijëve me probleme sociale edukuese – Shkup, por edhe se një i mitur përdor heroinë.

Analiza tregon se të miturit që vuajnë dënim me burg dhe të miturit të cilëve u është shqiptuar masë edukuese dërgim në shtëpinë edukuese përmirësuese nuk kanë

shkathtësi sociale adekuate dhe shkathtësi për ballafaqim me problemet në jetën e përditshme. Andaj manifestojnë forma të ndryshme të sjelljes së papranueshme shoqërore, që është në konflikt me normat morale dhe juridike.

Mungesa e shkathtësive sociale është një prej indikatorëve që tregon se nga ana e familjes, por edhe shoqërisë, janë bërë lëshime të caktuara në drejtim të ndërtimit të personaliteteve me vlera dhe sjellje morale pozitive.

Përkatësisht se, familja dhe shoqëria nuk kanë arritur të ushtrojnë ndikim edukues mbi këto persona të mitur.

Gjithashtu, hulumtimi tregon përkushtim të pamjaftueshëm të prindërve në kryerjen e funksionit prindëror, përkatësisht interesim të pamjaftueshëm për nevojat dhe problemet e fëmijëve, mospagim të kushteve për rritje dhe zhvillim normal, si dhe komunikim të zvogëluar dhe të prishur ndërmjet prindërve dhe fëmijëve.

Njëkohësisht, as shoqëria nuk ka ndërmarrë masa adekuate për ndihmë dhe mbështetje të këtyre të miturve përmes aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore të cilat do të kenë ndikim pozitiv mbi zhvillimin e të miturve, por është aktivizuar në fazat e mëvonshme kur të miturit tanimë kanë manifestuar forma të caktuara të sjelljes delikuede.

REKOMANDIMET PËR PARANDALIM MË EFEKTIV TË DELIKUENCËS SË TË MITURIT DHE MBËSHTETJE TË TË RINJVE NË RREZIK

Në bazë të analizës së bërë në institucionin ndëshkimor-përmirësues burgu në Ohër, të dhënat e marra nga internet anketa me të miturit dhe me personat e rritur, udhëzimet e Riadit si dhe njohuritë e konsultuara shkencore dhe profesionale vendore dhe ndërkombëtare, rekomandimet për parandalim më efikas të delikuencës së të miturit dhe mbështetja e të rinjve në rrezik u referohen tre niveleve: familjar, arsimor dhe shoqërore.

Niveli familjar

Mjedisi familjar mund të jetë faktor mbrojtës, përkatësisht t'i ofrojë ndihmë dhe mbështetje fëmijës për ballafaqim të suksesshëm me periudhat dhe krizat zhvillimore, ose të jetë faktor i rrezikut, përkatësisht të ketë ndikim negativ dhe të paraqesë shkak për zhvillimin e problemeve në vete, me veten ose me mjedisin.

Përmes familjes fëmijët hyjnë në kontakt me botën tjetër, duke i përvetësuar ose refuzuar vlerat, normat dhe ndikimet e tij. Si do të jetë raporti i fëmijës ndaj mjedisit më të gjerë,

varet shumë nga qëndrimi i familjes dhe mënyra në të cilën kjo funksionon në mjedisin shoqëror.

Familjet në të cilat ka marrëdhënie të ngrohta ndërnjerëzore dhe prindëri efektiv kanë gjasa më të vogla për paraqitje të sjelljes së papërshtatshme shoqërore dhe krimin e të miturit. Klima emocionale pozitive në familjen ndikon mbi ndërtimin e stabilitetit emocional dhe vetërespektit të lartë të të miturit. Kur familja është e lumtur dhe e kënaqur, i mituri zhvillohet në personalitet që nuk vjen në konflikt me shoqërinë dhe normat e tij të sjelljes.

Nga ana tjetër, në familjet ku ekziston shkallë e lartë e konflikteve familjare dhe martesore, prindëri joadekuate dhe dhunë, ka gjasa shumë më të mëdha që fëmijët të manifestojnë sjellje negative ose të bëhen kryerës së veprave penale. Mungesa e atmosferës së këndshme familjare ndikon në drejtim të përshtatjes së keqe emocionale dhe paraqitjes së paqëndrueshmërisë emocionale. Familjet që nuk kanë kryer edukim pozitiv, në të cilat fëmijët nuk i kanë marrë bazat e edukimit moral, nuk kanë përvetësuar sisteme të vlerave dhe shprehive pozitive krijojnë bazë për zhvillim të sjelljes së papërshtatshme shoqërore.

Në të kaluarën, puna profesionale me të miturit kryerës të veprave penale në pjesën më të madhe ka qenë e fokusuar në nivel individual, përkatësisht të gjitha përpjekjet kanë pasur për qëllim korrigjimin e personalitetit të të miturit. Praktika tregon se në raste të caktuara sjellja delikuede paraqet simptomë të disfunksionalitetit më të madh familjar dhe se nuk ka mundësi të tejkalohet gjendja negative vetëm përmes ndërhyrjeve që janë të orientuara ndaj personalitetit të të miturit. Qasja bashkëkohore në sferën e delikuencës së të miturit duhet t'i motivojë dhe aktivojë të gjitha anëtarët e familjes që ta marrin përsipër pjesën e vet të përgjegjësisë me qëllim tejkalimin e gjendjes në të cilën gjendet i mituri, e me atë edhe familja.

Në raportin me fëmijët, prindërit duhet t'u kushtojnë vëmendje më shumë aspekteve të cilat mund ta zvogëlojnë rrezikun nga përfshirja e fëmijëve në delikuencën e të miturve:

- Që të ndërtojnë një raport besimi, komunikimin e hapur me fëmijën duhet ta fillojnë që në fëmijërinë e hershme. Pritja deri në vitet e tinxherit që të fillojë me bisedime serioze me siguri nuk do t'i japë rezultatet e dëshiruara.
- Prindërit duhet të jenë fleksibilë dhe aktivitetet familjare t'i përshtatin ndaj nevojave të ndryshueshme të të miturit. Për shembull, gjatë planifikimit të kohës për pushim vjetor të jetë i përfshirë aktivisht edhe i mituri i cili do të ketë mundësi t'i shprehë ankesat dhe nevojat e veta.
- Prindërit duhet t'u japin fëmijë kohë dhe hapësirë të mjaftueshme për ta shprehur unin e tyre.
- Derisa aktivitetet e tyre nuk janë të rrezikshme për to ose për personat tjerë, është me rëndësi që t'u jepet mundësi të provojnë sjellje, role, interesa të ndryshme, me qëllim që të zbulojnë me të vërtetë se ku e gjejnë veten, e çfarë duan të refuzojnë.

Është me rëndësi t'u lejojnë fëmijëve të bëjnë edhe gabime, dhe t'u ndihmojnë të ballafaqohen me gabimet dhe të mësojnë prej tyre.

- Gjatë vendosjes së rregullave, është mirë që prindërit të tentojnë që ato të mos jenë shumë në numër, dhe të njëjtat të jenë për gjëra më të rëndësishme;
- Është me rëndësi që prindërit të dinë se çfarë u ndodh fëmijëve, me çfarë merren, ku dalin, me kë shoqërohen etj. Por me rëndësi është që prindi të manifestojë interesim të sinqertë për të miturin dhe jetën e tij, e jo të sillet si dikush që doemos duhet të kontrollojë gjithçka dhe ta pengojë nëse shkon diçka keq. Fëmijët kanë nevojë për inkurajim, mbështetje dhe mbrojtje nga prindërit. Pa informata adekuate për atë se çfarë u ndodh fëmijëve, prindërit nuk kanë mundësi t'u japin këshilla dhe udhëzime adekuate, e me atë fëmijët janë të privuar nga mbështetja dhe informatat adekuate që u nevojiten me qëllim ballafaqimin e suksesshëm dhe adekuat me sfidat. Megjithatë, gjatë kryerjes së këtij funksioni prindërit doemos duhet të jenë shumë të kujdesshëm që të mos ushtrojnë presion të panevojshëm mbi fëmijët e tyre. Në vend të kësaj, duhet të tregojnë interesim të sinqertë për fëmijët e tyre dhe t'i motivojnë që të bisedojnë në mënyrë të hapur dhe të sinqertë.
- Nëse i mituri nuk arrin të gjejë aktivitete në të cilat do të mundohet të vazhdojë t'i zhvillojë aftësitë, interesat dhe shkathtësitë e veta dhe në atë të gjejë kënaqësi, është mirë që të ndihmohet në përpjekjet e veta. Kjo mund të jetë me hobi, vullnetarizëm, praktikë etj.
- Megjithëse të miturit shpeshherë sillen sikur nuk kanë më nevojë për prindërit, është me rëndësi që prindërit ta njoftojnë fëmijën se gjithmonë janë të disponueshëm për bisedë dhe mbështetje;
- Është mirë që prindërit të jenë shembull për fëmijët e tyre për hulumtim, Dëgjim dhe përkushtim të vlerave dhe qëllimeve të caktuara. Të rinjtë shpesh dëshirojnë nga prindërit që ta dëgjojnë “tregimin” e tyre përkatësisht se si ato kanë sjellë vendime të caktuara jetësore dhe si kanë evoluar në atë që janë sot. Fëmijët nuk e formojnë personalitetin e tyre vetëm përmes veprimit të vetëdijshëm të prindërve, por edhe përmes perceptimit të procedurave të tyre dhe jetës së tyre të përditshme familjare, njëkohësisht duke pranuar dhe refuzuar një pjesë të madhe të këtyre ndikimeve. Procedurat e prindërve, përkatësisht sjellja e tyre ka ndikim shumë të madh, në krahasim me fjalët dhe këshillat. Më së mirë është të ketë harmonizim ndërmjet mënyrës së sjelljes së prindërve nëpërmjet të praktikuarit të modeleve pozitive dhe promovimit të vlerave pozitive të fëmijët e tyre.
- Me rëndësi është të inkurajohet pavarësia, në kuptim që fëmijëve t'u ofrohen disa zgjedhje dhe të nxiten të miratojnë vendim personal. Është mirë t'u bëhet me dije se nga miratimi i pavarur i vendimeve del edhe përgjegjësia për rezultatin e atyre vendimeve.

- Prindërit duhet t'u ndihmojnë fëmijëve të ndërtojnë modele përkatëse të sjelljes. Format pozitive, përkatësisht prosociale të sjelljes e përfshijnë të kuptuarit e të tjerëve, empatinë, ndihmën, të shfaqurit e ndjenjave, bashkëpunimin dhe ngjashëm, ndërsa sjellja antisociale ka të bëjë me format e ndryshme të sjelljes destruktive dhe agresive. Me rëndësi të jashtëzakonshme është që prindërit të fëmijët e tyre t'i formojnë mekanizmat përkatës të vetëkontrollit, veçanërisht në situatat e larta të stresit. Në situatat me shkallë të lartë të ngarkesës emocionale negative, të miturit me mekanizëm të zhvilluar të vetëkontrollit më shpesh zbatojnë mënyra përkatëse të reagimit, në dallim nga të miturit që nuk kanë kapacitete personale për vetëkontroll dhe këta zbatojnë mënyra agresive, destruktive ose vetëdestruktive të reagimit. Përballja joadekuatë me emocionet negative dhe stresi shfaqin shkallë të lartë të korrelacionit me paraqitjen e delikuentës së të miturve. Për këto shkaqe, prindërit dhe të gjitha subjektet relevante të cilët kanë ndikim mbi formimin e fëmijëve, është e nevojshme të punojnë në drejtim të formimit të kapaciteteve personale dhe resurseve të fëmijëve.
- Prindërit duhet t'u ndihmojnë të rinjtë të bëjnë dallimin midis asaj që është e lejuar nga ana morale dhe ligjore prej asaj që është e ndaluar dhe e sanksionuar, por gjithashtu edhe t'i orientojnë fëmijët e tyre të reagojnë në mënyrë përkatëse në situatat kur personat e tjerët - p.sh. anëtarët e familjes, moshatarët, autoriteti - i theksojnë ose i bindin të zbatojnë forma të caktuara negative të sjelljes. Në situata të caktuara të miturit sillen në mënyrë për të cilën dinë se është i gabuar, por frikohen nga dënimi, izolimi ose sanimi nga ana e personave të cilat i sjellin në këto veprime. Prindërit duhet të zhvillojnë aftësi të fëmijët në kushte të tilla të reagojnë në mënyrë e cila nuk do t'i sjellë në konflikt me ato persona të cilët çojnë në sjellje konkrete.

Niveli arsimor

Duke e pasur parasysh se nxënësit ballafaqohen me sfida të shumta personale, familjare dhe shoqërore, shkolla (bashkë me familjen) duhet të veprojë si një lloj i katalizatorit i cili do t'i filtrojë të gjitha ndikimet e dëmshme, ndërsa njëkohësisht do ta forcojë veprimin e faktorëve pozitivë. Njëkohësisht do të sugjerojë në pasojat nga format e ndryshme të sjelljes negative dhe njëkohësisht do t'i promovojë modelet dhe shembujt e mira nga mjedisi më i ngushtë dhe më i gjerë. Në vazhdim janë theksuar më tepër masa dhe aktivitete të cilat mund t'i zbatojë sistemi arsimor për uljen e rrezikut nga të shfaqurit e delikuentës së të miturve:

- Sistemi arsimor duhet të sigurojë mekanizëm për të parandaluar ndërprerjen e parakohshme të procesit arsimor nga ana e nxënësve. Kjo është veçanërisht e

rëndësishme për shkak të faktit se kategori të caktuara vulnerable të fëmijëve, për shkak të gjendjes në të cilën ndodhen, e lënë procesin arsimor dhe në këtë mënyrë cenueshmëria dhe ekspozimi i tyre ndaj rreziqeve sociale rritet. Që të realizohet ky qëllim, arsimi nuk duhet të jetë vetëm i detyrueshëm, por edhe i arritshëm për të gjithë fëmijët në vend.

- Aktivitetet në shkollë duhet të dimensionohen në pajtim me aftësitë e nxënësve. Shkolla nuk duhet të jetë faktor i rrezikut nëpërmjet caktimit të detyrave dhe obligimeve tepër të mëdha për nxënësit, të cilat nuk janë në pajtim me shkallën e zhvillimit të tyre intelektual dhe emocional.
- Me rëndësi të jashtëzakonshme është që nxënësit të ndjehen të sigurt në shkollë, andaj është i domosdoshëm zbatimi i vazhdueshëm i aktiviteteve edukativo-arsimore për ta inkurajuar tolerancën dhe modiskriminimin multietnik, si dhe parandalimin dhe ballafaqimin me dhunën e moshatarëve.
- Shkolla duhet të funksionojë sipas parimeve dhe rregullave të caktuara të sjelljes të cilat do të vendosin rend dhe disiplinë, por në të njëjtën kohë edhe do të krijojnë atmosferë në të cilën do të inkurajohet kureshtja, kreativiteti, dëshira dhe kërkimi i njohurive të reja, në pajtim me interesat dhe afinitetet e nxënësve.
- Përveç funksionit të saj arsimor, shkolla ka edhe funksion edukativ, i cili për fat të keq, në raste të caktuara lihet pas dore. Përveç dhënies së njohurive, zhvillimit të kreativitetit dhe kapaciteteve intelektuale të nxënësve dhe të tjerëve, shkolla është mjedis në të cilin duhet të punohet në ndërtimin e parimeve morale dhe vlerave etike të miturit. Është i domosdoshëm zbatimi i aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore nëpërmjet të cilave nxënësit do të mund të ndërtojnë sistem përkatës të vlerave në të cilin do të dominojë ndershmëria, humaniteti dhe dashuria.
- Lidhur me delikuecën e të miturve, shkolla është mjedis në të cilin mund të vërehet nëse paraqitet ndonjë problem tek i mituri. Shkolla ka mundësi për detektimin përkatës dhe në kohë të rreziqeve dhe problemeve me të cilat përballen nxënësit. Për këtë qëllim është i domosdoshëm trajnimi i mësimitdhënësit dhe kuadrit profesional në shkolla për detektimin e hershëm të fëmijëve në rrezik dhe veprim përkatës me to. Si dhe zhvillimi i mekanizmave efikase të bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet e tjera kompetente.
- Shkolla, bashkë me familjen, duhet të bëjë përpjekje të mëdha edhe në drejtim të plotësimit përkatës të kohës së lirë të të rinjve, me organizimin e aktiviteteve dhe programeve konkrete në këtë fushë. Mosorganizimi dhe mosplotësimi i kohës së lirë, shpie në tërheqjen në vetvete, ose në paraqitjen e formave të caktuara të sjelljes antisociale. Pamundësia që kohën e vet të lirë ta shfrytëzojnë në mënyrë përkatëse, p.sh.: me lojëra, argëtim, sport dhe ngjashëm, bën që një pjesë të të rinjve ta plotësojnë me aktivitete të cilat në njërën mënyrë ose në mënyrë tjetër

sanksionohen nga ana e shoqërisë. Të kaluarit e kohës së lirë në mjediset në të cilat konsumohet alkooli, droga dhe substancat e tjera psikotrope ose praktikohet sjellja kriminale, për të rinjtë është tërheqëse, veçanërisht në periudhën e trazuar të adoleshencës. Në formën e tillë rrethinës të rinjtë shumë lehtë do të përfshihen në sjelljen kriminale. Shkolla duhet të zhvillojë dhe zbatojë programe edukative mësimore dhe jashtëmësimore nëpërmjet të cilave do t'u mundësojnë nxënësve ta kalojnë kohën e lirë në një mënyrë pozitive dhe kreative në mënyrë përkatëse me nevojat, dëshirat dhe potencialet e tyre. Mes tjerash, nxënësve duhet t'u ofrojnë aktivitete në fushën e sportit, artit, shkencës, mbështetjes së komunitetit, punës praktike, dhe ngjashëm ku ata do të mund t'i demonstrojnë dhe zhvillojnë potencialet e tyre.

- Është i domosdoshëm përforsimi i rolit të këshillave të prindërve dhe përfshirja e tyre aktive në planifikimin dhe realizimin e programeve dhe aktiviteteve parandaluese dhe kurative.

Niveli shoqëror

Pushtetet qendrore dhe lokale përmes mekanizmave të tyre duhet të ndërtojnë një mjedis pozitiv shoqëror në të cilin do të dominojnë, promovojnë dhe vlerësojnë në mënyrë përkatëse vlerat dhe modelet pozitive të sjelljes, dhe në të njëjtën kohë në mënyrë përkatëse dhe parimore do të sanksionohen sjelljet që nuk janë në pajtim me normat morale dhe juridike të shoqërisë. Është me rëndësi t'i kushtohet vëmendje:

- Organizimit të aktiviteteve për ngritje të vetëdijes publike dhe shkallës së informimit të qytetarëve për aplikimin e stileve të shëndoshura jetësore. Me këto fushata duhet të informohen qytetarët për dukuri negative shoqërore siç janë: dhuna, dhuna familjare, keqpërdorimi seksual i fëmijëve dhe pedofilia, delikuenca e të miturve etj.
- Sensibilizimi i medieve për njoftim mediatik adekuat dhe shmangia e promovimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të modeleve joadekuate të sjelljes së të rinjve.
- Formimi dhe sigurimi i funksionimit adekuat i këshillave lokale për parandalim të delikuencës së të miturve. Këto këshilla duhet të fokusohen në detektimin e faktorëve të rrezikut dhe mbrojtjes në nivel lokal dhe të njëjtat në bashkëpunim me institucionet tjera relevante të propozojnë dhe realizojnë masa dhe aktivitete për parandalim dhe ballafaqim të suksesshëm me delikuencën e të miturve në nivel lokal.
- Shoqëria duhet t'i sigurojë ndihmë dhe mbështetje adekuate familjes me qëllim për të ushtruar ndikim pozitiv mbi fëmijët dhe për të krijuar kushte për rritjen dhe zhvillimin e tyre normal. Nevojitet që të zhvillohen shërbime për ndihmë dhe mbështetje të fëmijëve dhe familjeve në rrezik që do të përfshijnë ndihmë këshillëdhënëse,

këshillimore dhe lloj tjetër të ndihmës për parandalim dhe ballafaqim të suksesshëm me rreziqet sociale në të cilat gjenden ose ekziston rrezik për t'u gjendur. Mes tjerash, nevojitet që të krijohet rrjet i këshillimoreve për shkathtësi prindërore në numër sa më të madh të bashkësive lokale, të cilat do të jenë të ekipuara dhe përgatitura në mënyrë adekuate për përmbushjen e kësaj detyre jashtëzakonisht përgjegjëse. Këto këshillimore duhet t'u ofrojnë ndihmë dhe mbështetje familjeve që në mënyrë adekuate të ballafaqohen me të gjitha sfidat zhvillimore me të cilat ballafaqohet familja dhe anëtarët e tyre. Në këtë kontekst me rëndësi të veçantë është krijimi i kushteve edhe për fëmijët që kanë manifestuar tanimë forma të caktuara të sjelljes delikuede që të mund të marrin ndihmë për të marrë ndihmë dhe mbështetje adekuate në mjedisin në të cilin jetojnë.

- Vendosja e programeve funksionale dhe cilësore të cilat në një pjesë do të realizohen në kuadër të shkollave, ndërsa një pjesë në bashkësinë. Këto programe duhet të ofrojnë spektër të gjerë të aktiviteteve me qëllim që çdo i mitur të mund të gjejë aktivitete të cilat janë në pajtim me ankesat, interesat dhe potencialet e tij. Gjithashtu, këto programe duhet të orientohen edhe në ndërtimin e sistemeve të vlerave morale të të miturit dhe promovimin e stileve dhe shprehive të shëndosha jetësore. Në këtë sistem është e domosdoshme që të përfshihen aktivisht: shkollat, vetëqeverisja lokale, shoqëria civile – përfshirë edhe klubet sportive dhe organizatat kulturore-artistike – si dhe sektori afarist. Për atë qëllim, është i domosdoshëm zhvillimi i partneritetit efikas dhe bashkëpunimi në nivel lokal ndërmjet institucioneve të pushtetit qendror dhe lokal, sektorit privat dhe shoqërisë civile, bashkë ato duhet të krijojnë kushte që të rinjtë të mund të stërviten ose praktikojnë falas aktivitete sportive, të merren me aktivitete kulturore, artistike dhe aktivitete tjera. Është i domosdoshëm edhe përforcimi i kapaciteteve të organizatave rinore në nivel qendror dhe lokal me qëllim përfshirjen dhe pjesëmarrjen aktive të një numri sa më të madh të personave të rinj në aktivitete të tyre.

BIBLIOGRAFIA

- Dünkkel, F., Philip Horsfield Andrea Păroșanu (Eds.) (2015). European research in the restorative juvenile justice, volume I: Research and Selection of the Most Effective Juvenile Restorative Justice Practices in Europe: Snapshots from 28 EU Member States
- Strategjia nacionale për parandalim të delikuencës së të miturve (2010-2010). Këshill shtetëror për parandalim të delikuencës së fëmijëve.

https://drive.google.com/file/d/14JvEmCETUgljHIXJDHug8ET7J9aRqri_/view

- UN Guidelines for the Prevention of Juvenile Delinquency (The Riyadh Guidelines). Adopted and proclaimed by General Assembly resolution 45/112 of 14 December 1990
- Stamevski, V., Pavlovski, D., (2016). Koncepti “DREJTËSIA PËR FËMIJË” në ballafaqimin me paraqitjet e delikuencës së fëmijëve. Dialogu ndërkombëtar Lindje-Perëndim, Universiteti Gavrillo Romanoviq Derzhavin, Shën Nikollë.
- Terzian, M.A., Andrews, K.M., & Moore, K.A. (2011). Preventing Multiple Risky Behaviors: An Updated Framework for Policy and Practice. Washington DC: Child Trends.
- Programi vjetor për punën e Këshillit shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve për vitin 2019 dhe Plan veprimi me aktivitete programore. Këshilli shtetëror për parandalim të delikuencës së fëmijëve. <https://drive.google.com/file/d/1E-rfjGq2wYHtB1x0L3Lh7R9SuA-X6ZGc/view>
- Ligji për drejtësi për fëmijë, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 148 nga 29.10.2013.



ХОПС
ОПЦИИ ЗА ЗДРАВ ЖИВОТ СКОПЈЕ



At-Risk Youth Social Empowerment Network



Проект финансиран од ЕУ - проектот ARYSE (Социјално
зајакнување на младите во ризик) е финансиран од
Европската Унија, претставувана од Европската комисија



АСОЦИЈАЦИЈА
ЗЕНИТ



ИСИЕ

Instituti për hulumtime strategjike dhe edukim